

## KONTRATE SHITBLERJEJE KUOTASH

Ne Tirane, me date 02.01.2019, palet e meposhtme:

**ALB – STAR Shpk**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ("QKB") me NUIS J62903512W, date 15.2.1995, me seli ne Zona Industriale, Patos, Fier, Shqiperie, e cila ne perputhje me Vendimin e Asamblese se Ortakeve te saj, date 2.1.2019 perfaqesohet ne kete kontrate nga Sadik Ismailaj, shtetas shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 027357296, dhe Idajet Ismailaj, shtetas shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 033581369; (ne vijim "**Shitesi**")

dhe

**FINMAN Shpk**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ("QKB") me 5.12.2016, me NUIS L62405030K, me seli ne Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla nr. 2, Kati 5, Tirane, Shqiperi, e cila ne perputhje me Vendimin e Asamblese se Ortakeve te saj, date 2.1.2019 perfaqesohet ne kete kontrate nga Sadik Ismailaj, shtetas shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 027357296, dhe Idajet Ismailaj, shtetas shqiptar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 033581369; (ne vijim "**Bleresi**");

(ne vijim Shitesi dhe Bleresi referohen si "**Palet**");

### DUKE PASUR PARASYSH SE:

- I. Shitesi eshte pronari i ligishem i kuotes qe perfaqeson 100% te kapitalit te ASAB Shpk (me poshte referuar si "**Kuota**"), nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS L22519401V, date 19.1.2012 (ne vijim "**ASAB**" ose "**Shoqeria**");
- II. Bleresi i ka propozuar Shitesit blerjen e Kuotes;
- III. Shitesi eshte i gatshem te shese Kuoten tek Bleresi;

atehere Palet lidhin kete Kontrate per Shit-Blerjen e Kuotes (me poshte referuar si "**Kontrata**"), sipas termave dhe kushteve te meposhtme:

### Neni 1 Objekti i Kontrates

Sipas kushteve dhc detyrimeve te percaktuara ne kete Kontrate, Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi Kuoten bashke me te gjitha te drejtat dhc detyrimet qe rrjedhin nga Kuota.

### Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi per shitjen e Kuotes qe Bleresi duhet t'i paguaje Shitesit do te jete **100.000,00 (njqind mije) leke ("Çmimi i Shitjes")**.
- 2.2 Bleresi do te paguaje Cmimin e Shitjes ne llogarine bankare te Shitesit, siç eshte percaktuar me poshte:  
IBAN: AL77213110440000000000898168  
Llogaria nr. 00000898168  
Banka: Societe Generale Albania Sh.a

1

- 2.3 Çmimi i Shitjes do të paguhet në llogarë bankare të Shitesit, brenda 90 ditëve pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 2.4 Çdo komision për transferimin e Cmimit të Shitjes në llogarë bankare të Shitesit do të perballohet nga Bleresi.
- 2.5 Shitesi do të jetë përgjegjës për deklarin dhe pagesën e çdo taksi apo tatimi, nëse aplikohet ndaj Shitesit, në lidhje me shitjen e Kuotes.

### **Neni 3 Transferimi i Kuotes**

Transferimi i Kuotes ("**Transferimi**") dhe regjistrimi i kësaj Kontrate në Qendren Kombëtare të Biznesit do të kryhen pas pagesës së Cmimit të Shitjes nga Bleresi brenda afatit të përcaktuar në nenin 2, paragrafi 3.

### **Neni 4 Garancite e Shitesit**

Shitesi garanton se:

- 4.1 Kuota që i përket Shitesit përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.
- 4.2 Shitesi është pronari i ligjshëm i Kuotes dhe e ka shlyer atë teresisht.
- 4.3 Shitesi deklaron dhe garanton se Kuota është e lirë nga barre apo pretendim i ndonjë pale të tretë.
- 4.4 Shitesi heq dorë nga çdo pretendim mbi fitimin e Shoqërisë në vitin financiar 2019, nëse ka.

### **Neni 5 Garancite e Bleresit**

Bleresi deklaron, garanton, dhe merr përsipër kundrejt Shitesit sa më poshtë:

- 5.1 Bleresi ka fonde të disponueshme dhe do të paguajë Çmimin e Shitjes brenda afatit të rënë dakord në nenin 2.3 të kësaj Kontrate.
- 5.2 Bleresi merr përsipër të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme, pa asnjë kufizim, në lidhje me Kuotën, si ortak i 100% të kapitalit të ASAB Shpk dhe nëpërmjet kësaj Kontrate heq dorë nga çdo e drejtë për t'i kundërdrejtuar ndonjë pretendim Shitesit në të ardhmen në lidhje me detyrime të pashlyera ose pretendime të paleve të tretë në lidhje me Kuotën ose me përgjegjësinë e tij si ortak i 100% të kapitalit të ASAB Shpk.

### **Neni 6 Zgjidhja e Kontrates**

Kjo Kontrate mund të zgjidhet menjëherë nga Shitesi, pas dorëzimit të një njoftimi me shkrim Bleresit, në qoftë se parashikimet e nenit 2.3 nuk janë plotësuar me sukses.

### **Neni 7 Ligji I zbatueshëm dhe gjykata kompetente**

- 7.1 Kjo Kontrate do të interpretohet nga ne përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.



2

- 7.2 Ne rast te ndonje mosmarreveshje, Palet do te perpiqen ta zgjidhin ate miqesisht, perndryshe do t'i drejtohen per zgjidhje gjykates kompetente shqiptare.

### **Neni 8** **Kushte te pergjithshme**


- 8.1 Nese ndonje nga pjeset e kesaj Kontrate do te behet e pazbatueshme per çfare do arsye, pjesa e mbetur e kesaj Kontrate do te vazhdoje te jete ne fuqi me efekt te plote.
- 8.2 Kjo Kontrate perben te marreveshjen e plote dhe te vetme midis Paleve per shit-blerjen e Kuotes dhe zevendeson çdo marreveshje paraprake mes tyre para dates se kesaj Kontrate.
- 8.3 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 4 kopje te njejta ne gjuhen shqipe.
- 8.4 Kjo Kontrate mund te ndryshohet vetem me marreveshje me shkrim, te nenshkruar nga te dyja Palet.

Palet e nenshkruajne kete Kontrate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne daten e kesaj Kontrate.


#### SHITESI

**ALB – STAR Shpk**  
Perfaqesuar nga:

**Sadik Ismailaj**



**Idajet Ismailaj**






#### BLERESI

**FINMAN Shpk**  
Perfaqesuar nga:

**Sadik Ismailaj**



**Idajet Ismailaj**

